



Ftesë për ofertë

Titulli i ofertës: Furnizim, Implementim dhe Mirëmbajtje e Sistemit për Menaxhimin e Auditimit të Brendshëm

Data e hapjes për ofertim: 09/03/2026

Data e mbylljes për ofertim: 24/03/2026

Agjencioni për financim në Kosovë - AFK fton të gjitha kompanitë shërbyese të interesuara të paraqesin ofertat e tyre për “Furnizim, Implementim dhe Mirëmbajtje e Sistemit për Menaxhimin e Auditimit të Brendshëm”

Objekti i kontratës

Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e një softueri për menaxhimin e auditimit të brendshëm, që mbështet procesin e auditimit bazuar në rrezik dhe përmirëson efikasitetin e planifikimit, dokumentimit, raportimit dhe monitorimit të aktiviteteve të auditimit.

Specifikimet kryesore të sistemit

Software duhet të përfshijë funksionalitetet në vijim:

1. Menaxhimin e universit të auditimit dhe vlerësimin e rreziqeve.
2. Planifikimin e auditimit dhe krijimin e planit vjetor të auditimit.
3. Hartimin e programeve dhe procedurave të auditimit.
4. Dokumentimin elektronik të dosjeve të punës së auditimit dhe menaxhimin e evidencave.
5. Përdorimin e metodave statistikore për përzgjedhjen e mostrave.
6. Menaxhimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.
7. Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
8. Gjenerimin e raporteve të auditimit.
9. Sigurinë e sistemit dhe kontrollin e qasjes (role-based access dhe audit trail).
10. Instalimin, konfigurimin e sistemit, trajnimin e përdoruesve dhe ofrimin e mbështetjes teknike.

Sistemi duhet të jetë **web-based** dhe i aksesueshëm nga disa përdorues njëkohësisht.

Kualifikimet e ofertuesve

- Përvojë në furnizimin dhe implementimin e sistemeve informatike
- Përvojë në projekte të ngjashme me këtë ftesë
- Kapacitet teknik dhe organizativ

Dokumentet që duhet të dorëzohen

- Përshkrimi i detajuar i sistemit të propozuar dhe funksionaliteteve të tij
- Specifikimet teknike të softuerit të propozuar
- Referencat e projekteve të ngjashme
- Oferta financiare e detajuar

Institucioni rezervon të drejtën të pranojë edhe zgjidhje të tjera teknike që përmbushin objektivat dhe funksionalitetet e kërkuara, edhe nëse ato nuk përputhen plotësisht me specifikimet e mësipërme.

Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Të gjitha ofertat origjinale të dërgohen të mbyllura në zarf në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë: Rruga "Lidhja e Prizrenit" Nr. 20, kodi postar 30 000, ose edhe përmes postës elektronike në prokurimi@afkonline.org.

- **Afati i fundit i pranimi të ofertave: 24/03/2026.**